

**VENDIM**  
**Nr. 897, datë 12.12.2012**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 338, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”,**  
**TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 53 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në tekstin e modelit të tregut të energjisë elektrike, që i bashkëlidhet vendimit nr. 338, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në fund të paragrafit të dytë të pikës 4.4, fjalët “... me çmime tregu ose furnizuesit publikë me shumicë me çmim të rregulluar dhe kontratë të miratuar nga ERE-ja ...” zëvendësohen me fjalët “... apo furnizuesi publik me shumicë dhe/ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, me çmime të vendosura në kontratën e shitblerjes të negociuar dhe të rënë dakord ndërmjet palëve”.

b) Në pikën 4.13, A, nënpika 5, fjalët “... e PPE-ve ...” hiqen.

c) Në fund të pikave 6.1, 6.2, 6.4 dhe 6.5 shtohen fjalët “... minimumi i lejuar i disbalancave zvogëlohet me 1% për çdo vit, duke filluar nga viti 2013.”.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**